



KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGIJË ELEKTRIKE S.H.A.
KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY J.S.C.
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA DISTRIBUCIJU I SNABEVAŃJE ELEKTRIČNOM ENERGIJOM D.O.

KEDS - S.H.A.

Nr. 17 Dt. 03.03.2023
HQ 1

Ymer Fejzullahu
Kryesues i Bordit të ZRrE-së

Alpin Dogan
Kryeshf Ekzekutiv
KEDS sh.a.

03 Mars 2023

Lënda: Komentet e OSSH-së në Raportin Konsultativ të ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale për periudhën e tretë rregullative 2023-2027

I nderuar Fejzullahu,

Ky dokument përmbledh komentet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ndaj Raportit Konsultativ të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) mbi të Hyrat e Lejuara Maksimale të periudhën e tretë rregullative 2023-2027.

OSSH vlerëson mundësinë e dhënë për të dhënë komente mbi çështjet e rëndësishme të ngritura në Raportin Konsultativ dhe kërkon nga ZRRE që të shqyrtojë seriozisht të gjitha çështjet e ngritura para çdo vendimi përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale për periudhën rregullative 2023-2027.

Për shkak të rëndësisë së madhe të këtij procesi, OSSH është e hapur dhe e gatshme për diskutime të mëtejshme sa herë që është e nevojshme.

Me respekt,


Alpin Dogan
Kryeshf Ekzekutiv





**Komentet e OSSH-së ndaj Raportit Konsultativ të ZRRE-së për të Hyrat e
Lejuara Maksimale për Periudhën e Tretë Rregullative (2023-2027)**



Përmbajtja

1. Hyrje.....	3
2. Baza e asetëve të rregulluara (RAB) dhe Plani investiv	3
2.1. Përshatjet për investimet kapitale në PRR2.....	3
2.2. Plani investiv për periudhën e ardhshme rregullative (PRR3)	5
3. Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes	7
4. Humbjet dhe të hyrat e parregulluara	8
4.1. Kosto e humbjeve të energjisë.....	8
4.2. Të hyrat e parregulluara dhe kostot e përjashtuara.....	10
5. Përshatjet e rregullta vjetore 2023	10
6. Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për periudhën rregullative	12



1. Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 16 shkurt 2023 ka publikuar Raportin Konsultativ mbi të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes në kuadër të periudhës së tretë rregullative (2023-2027). Në këtë raport ZRRE ka paraqitur vlerësimin fillestar për të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH, bazuar në Propozimin e OSSH-së për të hyrat e lejuara maksimale për periudhën e tretë rregullative të dorëzuar me datë 22 nëntor 2022.

Gjatë llogaritjes së të hyrave të lejuara maksimale OSSH ka përdorur vlerat hyrëse të përcaktuara nga ZRRE për periudhën rregullative 2023-2027 si: Mesataren e ponderuar e kostos së kapitalit (WACC) të përcaktuar me vendimi nr.V_1634_2022, Faktorin e efikasitetit të përcaktuar me vendim nr.V_1635_2022 dhe cakun e reduktimit të humbjeve të përcaktuar me vendim nr.V_1636_2022.

Në vijim të këtij dokumenti OSSH do të paraqes qëndrimin e saj lidhur me propozimin e ZRRE-së për të hyrat e lejuara maksimale për periudhën e tretë rregullative 2023-2027, si dhe qëndrimin lidhur me llogaritjet e ZRRE-së për përshtatjet e rregullta vjetor për vitin 2023 sipas Raportit Konsultativ.

2. Baza e aseteve të rregulluara (RAB) dhe Plani investiv

Në këtë seksion OSSH paraqet qëndrimet/komentet e saj mbi përshtatjet e investimeve kapitale të realizuara në periudhën e dytë rregullative, si dhe investimet kapitale të propozuara për periudhën e tretë rregullative.

2.1.Përshtatjet për investimet kapitale në PRR2

Zyra e rregullatorit për energji për periudhën së dytë rregullative 2018-2022 ka lejuar investimet në vlerë prej 131 mil€. Gjatë kësaj periudhe, në baza vjetore, OSSH ka njoftuar ZRRE për gjitha planet investive në rrjet dhe domosdoshmërinë e tyre.

Jemi dëshmitar se vitet e fundit si rezultat i zhvillimeve të shpejta në zonat urbane, rritja e kërkesës/ngarkesës vazhdimisht ka mbingarkuar daljet ekzistuese, si rezultat disa dalje kanë arritë operimin në kapacitetet maksimale të linjës në kohën e pikut. Me qëllim të shmangies së ndërprerjeve për shkak të mbingarkesave, OSSH është dashur të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të përmbushur detyrimin për t'u ofruar të gjithë përdoruesve të sistemit energji cilësore dhe mundësinë e kycjes, në përputhje me ligjin e energjisë elektrike dhe kodin e rrjetit të shpërndarjes.



Gjatë 5 viteve të fundit, OSSH është përballur me shumë sfida që kanë ndikuar në realizimin e planit të investimit të miratuar për periudhën 2018-2022, por që ishin jashtë kontrollit të OSSH-së. Plani 5 vjeçar investues (2018-2022) u aprovua nga ZRRE në tremujorin e fundit të vitit 2018 për shkak të mungesës së kuorumit në bordin e ZRRE-së. Gjatë pothuajse tërë vitit 2018, OSSH nuk ishte në dijeni se cilat projekte do t'i aprovonte ZRRE-ja, por në pamundësi të ndërprerjes së investimeve për shkak të nevojave të rrjetit, OSSH investoi sipas vlerësimit të tij në projektet e domosdoshme për siguri dhe zgjerim të rrjetit. Gjatë vitit 2020, OSSH u ndikua nga përhapja e pandemisë Covid-19, ndërsa gjatë vitit 2021 dhe 2022 u ndikua edhe nga kriza energjetike, e të cilat jo vetëm që krijuan vonesa në zbatimin e planeve të investimeve por rritën edhe kostot e zbatimit të tyre. Pavarësisht këtyre sfidave OSSH ka arritur të investojë 107.28 milion euro për periudhën 2018-2022, nga 131 milion € sa kishte aprovuar rregullatori për të njëjtën periudhë.

Investimet e realizuara nga OSSH në periudhën e dytë rregullative janë reflektuar edhe në propozimin fillestar të OSSH-se për të hyrat e lejuara maksimale për periudhën e tretë rregullative. Mirëpo, ZRRE në raportin konsultativ të publikuar më 16 shkurt 2023, ka zvogëluar investimet e realizuara në vlerën prej 29.7 milion euro me arsyetimin se janë investime të cilat nuk janë aprovuar nga ZRRE.

<i>Investimet kapitale</i>	€000s
PRR2 aprovuara	131,443
PRR2 realizuara	107,277
Të shtuara në mbylljen e RAB për PRR2	77,577

Për më tepër, për të njëjtat ZRRE-ja ka bërë përshtatjen e zhvlerësimit të lejuar dhe kthimit të lejuar duke aplikuar normën e përbërë të interesit dhe inflacionit, koncept i cili nuk mund të aplikohet në investimet reale.

Sidoqoftë, ZRRE i ka cilësuar këto projekte si investime të domosdoshme dhe të njëjtat i bart në 4 vitet e fundit të periudhës së tretë rregullative, megjithëse të njëjtat janë energjizuar dhe konsumatorët janë duke përfituar nga këto investime.

OSSH ka njoftuar ZRRE-në qoftë përmes raportit për investime vjetore, qoftë përmes takimeve zyrtare lidhur me zbatimin e këtyre projekteve dhe zyrtarisht OSSH nuk ka pranuar ndonjë letër zyrtare nga ZRRE përmes së cilës do t'i kërkohej ndërprerjen e tyre. Prandaj, duke ditur rëndësinë dhe domosdoshmërinë e tyre për sistemin e shpërndarjes, këto investime duhet të njihen. Duke e shtyrë njohjen për periudhën e ardhshme rregullatore, OSSH-së i lihet të përballojë kostot e investimeve pa të hyra përkatëse, duke e vënë në rrezik funksionimin e përditshëm të OSSH.

Është e rëndësishme të theksohet se investimet e realizuara dhe të panjohura, e të cilat po shfrytëzohen nga konsumatorët, amortizohen dhe kërkojnë mirëmbajtje të vazhdueshme, kosto kjo



e cila nuk po i lejohet OSSH-së në këtë periudhë rregullative, duke ulur bazën e aseteve në mënyrë fiktive.

Marrë parasysh argumentet e lartpërmendura dhe parimet ekonomike dhe financiare, OSSH kërkon nga ZRRE që këto investime të njihen ashtu siç janë realizuar në periudhën e realizimit të tyre.

2.2.Plani investiv për periudhën e ardhshme rregullative (PRR3)

Ashtu siç kërkohet me legjislacionin në fuqi OSSH-ja ka përgatitur Planin e investimeve për vitet 2023-2027 së bashku me analizën e kostos dhe përfitimit (Cost/Benefit analysis) të cilat janë dorëzuar në ZRRE për aprovim.

Kriteret për përzgjedhjen e planit të investimeve 5 vjeçare u fokusuan kryesisht në projektet ku ka rënie të tensionit, ngarkesë në rrjet, humbjet, indeksat e ndërprerjeve, kërkesa për energji elektrike, rritje të konsumit, vjetërsinë e rrjetit të shpërndarjes dhe numrin e konsumatorëve.

OSSH në planin pesëvjeçar investues për periudhën rregullative 2023-2027 ka propozuar projekte kapitale në vlerë prej 167mil€, të cilat janë bërë bazuar në analiza teknike dhe me qëllim të arritjes së caktuar të humbjeve të përcaktuara nga ZRRE.

ZRRE-ja me vendimin numër V_1636_2022 ka aprovuar cakun e lejuar të humbjeve për periudhën e tretë rregullative. Është paradoksale që pas vendimit për cakun e humbjeve ZRRE ka zvogëluar investimet në mënyrë të njëanshme, duke ia pamundësuar OSSH-së arritjet e objektivave të humbjeve të përcaktuara për periudhën e tretë rregullative.

ZRRE në raportin konsultativ ka vlerësuar projektet kapitale për periudhën e ardhshme rregullative në vlerë prej 122.1mil€, duke zvogëluar projektet e fokusuar në tensionon e ultë dhe njehsorët elektrik, të ndërlidhura drejtpërsëdrejti me cakun e humbjeve.

Në investimet e periudhës së tretë rregullative, siç u argumentua edhe më lartë, ZRRE ka përfshirë edhe projektet e realizuara në periudhën e dytë rregullative në vlerë prej 29.7mil€. Rrjedhimisht, vlera përfundimtare e investimeve për periudhën e tretë rregullative është 151.7 mil€ siç paraqitet në tabelën më poshtë:



€000s	Totali	PRR3				
		2023	2024	2025	2026	2027
		Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Të dorëzuara nga OSSH						
Shpenzimet kapitale	166,868	31,705	35,100	35,883	32,476	31,706
Propozimet e ZRRE-së						
Shpenzimet kapitale	151,771	28,571	37,695	36,056	29,384	20,065
- Projektet nga PRR 3	122,071	28,571	30,348	27,221	20,775	15,156
- Projektet e bartura nga PRR2	29,700	-	7,347	8,836	8,609	4,908

Është e rëndësishme të theksohet se vlerësimet e ZRRE-së për planin investimeve 2023-2027 nuk janë në përputhje me analizat teknike dhe nevojat e rrjetit, me një theks të veçantë për 2 vitet e fundit, mandej të njëjtat nuk janë në harmoni as me Marrëveshjen e Implementimit të datës 17 tetor 2012, nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, Investitorë, KEK sh.a. dhe KEDS sh.a.

Ashtu siç është argumentuar më lartë, OSSH në propozimin e vet, ka përfshirë projektet e periudhës së dytë rregulative në vitin 2023 i paraqitur si më poshtë:

€000s	Totali	PRR3				
		2023	2024	2025	2026	2027
		Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Të dorëzuara nga OSSH						
Shpenzimet kapitale	166,868	31,705	35,100	35,883	32,476	31,706

Bazuar në propozimin e OSSH-së për periudhën e tretë rregulative, vlera e RAB përfundimtar për OSSH është përmbledhur në tabelën në vijim:

€000s	PRR3				
	2023	2024	2025	2026	2027
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
RAB në hapje	236,012	248,636	262,751	275,642	284,235
Investimet (Shtesat)	31,705	35,100	35,883	32,476	31,706
Zhvlerësimi	19,080	20,986	22,991	23,883	25,408
RAB në mbyllje	248,636	262,751	275,642	284,235	290,533



3. Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes (OPEX)

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes përbëhen nga kostot e mirëmbajtjes, kostot operative dhe kostot tjera të ndërlidhura me operimet e OSSH-së. Në raportin konsultativ ZRRE ka lejuar nivele më të ulëta se ato të propozuara nga OSSH duke e vënë në rrezik serioz mbarëvajtjen e operimeve të OSSH-së për pesë vitet e ardhshme.

Kostot e mirëmbajtjes përfaqësojnë koston për çmimin dhe materialet. Ashtu siç është theksuar në propozimin për të hyrat e lejuara maksimale për periudhën e tretë rregullative, rritja e çmimeve të materialeve ka qenë faktor ndikues në rritjen e kostove për kategoritë Riparimet, mirëmbajtja & materialet.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur vetëm disa shembuj të ndryshimit të çmimeve, ndërmjet vitit 2018 (viti i parë i periudhës së dytë rregullative) dhe vitit 2022.

Përshkrimi i mallit	Nëntor 2018	Nëntor 2022	Raporti i ndryshimit në %
Alumini	1,966.00	2,391.00	21.62%
Bakri	6,826.55	8,110.00	18.8%
Betoni (m3)	56.05	64.90	15.79%
Karburanti	1.21	1.73	42.98%
Brent Petrol	67.29	88.26	31.16%

Meqenëse trendi i rritjes së çmimeve është duke vazhduar dhe të njëjtat janë jashtë kontrollit të OSSH, mos-njohja e këtyre kostove, si dhe aplikimi i faktorit të efikasitetit në këtë linjë, është e paarsyeshme. Prandaj, është i domosdoshëm rishikimi i kostove.

Ligji Nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme i miratuar në vitin 2018, parasheh që në vitin e 5 tatimor (2023) të mos ketë zbritje të përgjithshme për tatimin e pronave, në dallim nga vitet e kaluara kur është aplikuar zbritja e përcaktuar sipas këtij ligji. Pra viti 2023 është viti i parë që bëhet faturimi i plotë i tatimit në pronë. Për me tepër, të njëjtat gjithashtu kanë shënuar rritje. Në këtë kuptim meqë kostot nga tatimi në pronë janë kosto jashtë kontrollit të OSSH kërkojmë nga ZRRE të reflektoj këto kosto gjatë vendosjes për kostot e OPEX për periudhën e ardhshme rregullative.

Gjithashtu edhe çmimet për sigurim të aseteve dhe palëve të treta janë rritur për 24.45 % dhe marrë parasysh se të njëjtat janë jashtë kontrollit të OSSH-së, të njëjtat duhen të reflektohen në OPEX-in përfundimtar.



Në propozimin për të hyrat e lejuara maksimale për periudhën 2023-2027, OSSH gjithashtu ka kërkuar nga ZRRE që të vlerësoj çështjen e ngritjes së pagave për punonjësit e kompanisë, e cila nuk është e harmonizuar me pagat e operatoreve të tjerë të sektorit të energjisë në Kosovë. Për më tepër, OSSH-ja ka argumentuar që si rezultat i rritjes së inflacionit është rënduar tej mase buxheti i punonjësve të kompanisë, duke rritur presion për rritje të pagave.

Inflacioni i cili përshtatet në OPEX është në nivel të Evropës dhe nuk korrespondon me inflacionin e Kosovës, kostot e të cilës i paguajnë punëtorët. Për më tepër aplikimi i faktorit të efikasitetit në linjën e pagave dëmton edhe vet njohjen e inflacionit që kompania mund ta lejoj. Mos-reflektimi i nivelizimit të pagave të OSSH-së në sektorin e energjisë elektrike në vend rrezikon dukshëm qëndrueshmërinë operative të OSSH-së, të cila po përballet me largim të vazhdueshëm të punëtorëve profesional. Për më tepër rritja e pagave në sektorin publik dhe ndihmat e ofruara në këtë sektor me qëllim të uljes së ndikimit të inflacionit, kanë rritur edhe më shumë pakënaqësitë e punonjësve të OSSH-së.

Marrë parasysh si më lartë, propozimi i OSSH për kategorinë e shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes duhet të pranohet i plotë dhe pa shkurtime. Duke i lejuar Operatorit të Shpërndarjes t'i njihen kostot e rritura në OPEX-in e saj të lejuar, do të ndihmojë operatorin të jetë në gjendje të mbajë një fuqi punëtore kompetente dhe të kualifikuar, e cila është thelbësore për aftësinë e saj për të ofruar shërbim të besueshëm dhe efikas. Për më tepër, kjo i ndihmon operatorit që në një afat më të gjatë, të jetë në gjende t'i menaxhojë kostot e saj operative në mënyrë më efektive, gjë që mund të çojë në përmirësimin e shërbimeve dhe stabilitetit financiar.

4. Humbjet dhe të hyrat e parregulluara

4.1.Kosto e humbjeve të energjisë

ZRRE në nëntor të vitit 2022 ka aprovuar cakun e reduktimit të humbjeve për periudhën e tretë rregullative si më poshtë:

<i>Humbjet e lejuara</i>	<i>Njësia</i>	<i>2023</i>	<i>2024</i>	<i>2025</i>	<i>2026</i>	<i>2027</i>
Lejimi i humbjeve për OSSH	%	15.1	14.7	13.3	12.1	11.1
Caku i reduktimit të humbjeve	%	-	0.4	1.4	1.2	1.0
Faktori i ndarjes së humbjeve	%	50/50	0	0	0	0



Duke qenë së kostot e humbjeve nuk janë parametër fiks gjatë periudhës rregullative por janë subjekt i përshtatjeve të rregullta vjetore, ZRRE në Rrapotin Konsultiv ka paraqitur propozimin e kostos të humbjeve vetëm për vitin 2023.

Në propozimin e ZRRE-së për kostot e humbjeve për vitin 2023 ka parashikuar energjinë në hyrje 6,220 GWh ndërsa çmimin e blerjes në 86€/MWh. Lidhur me energjinë në hyrje të shpërndarjes (EED) ZRRE ka përdorur të njëjtën metodologji sikurse viteve të kaluara duke konsideruar vetëm nivelin e lejuar të humbjeve në nivelin e shpërndarjes. OSSH edhe në të kaluarën nuk është pajtuar me metodologjinë e përdorur, meqenëse nuk është në përputhje me metodologjinë e aprovuar në Bilancin e energjisë dhe metodologjinë e përcaktuara në Rregullën për të Hyrat e OSSH-së, duke rezultuar me konkluzione të gabuara. OSSH pajtohet që për qëllime tarifore duhet të përdor nivelin e njohur të humbjeve gjatë llogaritjes së kostos së lejuara të humbjeve, megjithatë parashikimi më i ulët i energjisë në hyrje të nivelit të shpërndarjes nënkupton subvencionimin e një pjese të kostove nga OSSH në një vit relevant dhe respektivisht përshtatje më të mëdha gjatë vitit të ardhshëm, duke krijuar probleme financimi.

OSSH në këtë aplikim ka përditësuar blerjet e energjisë për mbulimin e humbjeve në bazë të bilancit të aprovuar të energjisë për vitin 2023. Në parashikimin e blerjeve të energjisë, sikurse ZRRE-ja, ka marr parasysh shkëmbimet KEK-KESH dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/117 dhe 02/117 të datës 29.12.2022. Megjithatë në aplikimin e tij OSSH ka paraqitur edhe kostot për kapacitet për energjinë nga KESH, të cilat kosto janë të domosdoshme për shfrytëzimin e plotë të kësaj energjie, në të kundërtën mos-njohja e kostove të kapacitet rrezikon sjelljen e energjisë nga KESH, duke rrezikuar që kjo energji tutje të mbulohet përmes importit ditor (intraday) e cila ka kosto më të lartë dhe të panjohur në tarifa në vitin relevant.

Pjesa e pambuluar nga prodhimi vendor parashihet të mbulohet përmes importit të energjisë elektrike, të cilat që nga kriza energjetike janë të larta dhe të paqëndrueshme. Parashikimet në tregjet ndërkombëtare gjithashtu parashihen të jenë jo stabile edhe gjatë vitit 2023, prandaj parashikimi i drejtë i tyre, duke përfshirë edhe kostot për kapacitet janë të domosdoshme. Si rezultat i mos-reflektimit të drejtë të kostove të larta të importit, OSSH gjatë dy viteve të fundit ka operuar nën kosto andaj me qëllim që të sigurohet likuiditet i mjaftueshme në këtë dokument OSSH ka përdorur çmimet e prishtme në bursat ndërkombëtare, duke aplikuar edhe kostot e kapacitetit, si kostot shtesë që aplikohet në çmimin përfundimtar.

Bazuar te lartë thënat propozimi i OSSH-së për koston e humbjeve për vitin 2023 është si më poshtë:



€000s		2023	2023
Inputet për kalkulim	Njësia	Propozuar -ZRRE	Propozuar -OSSH
Energjia që hyn në shpërndarje	GWh	6,220	6,287
Lejimi i humbjes	%	15.1%	15.1%
Humbjet	GWh	939	949
Çmimi i blerjes	€/MWh	86	95
Kostot totale	€000s	80,906	90,457

4.2. Të hyrat e parregulluara dhe kostot e përjashtuara

ZRRE në MAR-in e propozuar për periudhën e tretë rregullative ka zbritur kostot e përjashtuara në vlerë prej 0.4 mil€, duke mos ofruar argumente lidhur me zbritjen e tyre.

Sipas rregullës për të Hyrat e OSSH-së, të hyrat e lejuara maksimale nuk duhet të mbulojnë kostot për kryerjen e ndonjë shërbimi (duke përfshirë këtu shërbimet rreth linjave elektrike apo stabilimenteve elektrike) që caktohet të jetë shërbim i përjashtuar sipas Shtojcës 5, duke përfshirë a) shërbime nga të cilat përfiton në mënyrë të veçantë ndonjë palë e tretë që e kërkon shërbimin dhe b) të njëjtat mbulohet nga tarifatat apo taksat tjera dhe jo nga tarifatat për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes.

Marrë parasysh se ZRRE-ja ka zbritur të hyrat e parregulluara në vlerë prej 5 milion euro, të cilat përfshijnë të hyrat nga shërbimet e përcaktuara në shtojcën 5 të rregullës, zbritja e kostove të përjashtuara që ndërlidhen me dhënien e këtij shërbimi është e paarsyeshme. Si rezultat, të njëjtat nuk duhen të zbriten nga të hyrat e lejuara maksimale.

5. Përshtatjet e rregullta vjetore 2023

Përshtatjet e rregullta vjetore nënkuptojnë përshtatjet e kostove aktuale duke marrë për bazë të hyrat aktuale, pra faktorin korrigjues. Çdo mbi apo nën lejim i kostove në raport me të hyrat duhet të përshtat gjatë procesit të rregullt tarifor.

Është vërejtur se ZRRE-ja në përshtatjet për inflacion të shpenzimeve operative, nuk ka marrë parasysh total OPEX-in e aprovuar për vitin 2022. Marrë parasysh se rregulla për të hyrat e OSSH-



së definojnë sakë përshtatjen për normë të inflacionit, OSSH në këtë raport ka bërë përshtatjet e plotë të kostove operative të lejuara nga ZRRE për vitin 2022.

OSSH në aplikimin e tij ka kërkuar që t'i njihen kostot e jobalancave për muajt korrik-shtator, të cilat janë shkaktuar si rezultat i pamundësisë së blerjes së energjisë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve, për shkak të ngjarjes së jashtëzakonshme dhe pas ndërmarrjes të të gjitha veprimeve për parandalimin e tyre. Për më tepër, OSSH ka argumentuar se kërkuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për të mos lejuar devijime në sistem, por të cilat nuk janë aplikuar saktë, duke lejuar shkaktimin e jobalancave në sistem. Megjithatë, ZRRE nuk i ka trajtuar të njëjtat në raportin konsultativ.

OSSH në këtë raport ka përfshirë në çmimin mesatar të realizuar të blerjeve edhe kostot për jobalancat për periudhën korrik-shtator dhe kërkon nga ZRRE që të njëjtat të njihen në përshtatjet e kostove të humbjeve për vitin 2022, në të kundërtën do të jetë e pamundur që këto kosto tu paguhet palëve të treta përderisa të njëjtat nuk njihen në tarifa.

Marrë parasysh si më lartë, faktori korigjues i OSSH-së për vitin 2022 është 28.5 milion euro nga 24.94 sa ka propozuar ZRRE-ja në Raportin Konsultativ.

Faktori korigjues i të hyrave - KREV	Njësia	ZRRE	OSSH
AACat-1	mil€	189.00	192.28
ARRt-1	mil€	166.02	166.02
I _t	%	8.51	8.51
KREV = (AACat-1 - ARRt-1)*(1+I_t)	mil€	24.94	28.50

ZRRE në raportin konsultativ, ka ndarë faktorin korigjues (KREV) për 5 vite dhe ka shpërndarë të njëjtët përgjatë periudhës së tretë rregullative në mënyrë të barabartë, duke e trajtuar të njëjtën ngjashëm sikurse korigjimet që bëhen për periudhë rregullative.

Është e rëndësishme të theksohet se qëllimi i vendosjes së faktorit korigjues është që të përshtat kostot për çdo mbi apo nën lejim të kostove në raport me të hyrat, i cili duhet të përshtat gjatë procesit të rregullt tarifor, qëllimi i së cilës është të kthejë fitimin apo humbjen nga kostot e lejuara tek operatori.

Kostot prej 28.5 mil eurove shtesë, të cilat nuk kanë qenë të njohura në tarifat e vitit 2022, janë mbuluar nga operatori përgjatë vitit relevant, andaj shpërndarja e tyre në 5 vite është e padrejtë dhe rrezikon pozitën financiare të OSSH-së.



Trajtimi i korigjimeve per periudhe rregullative e ndarë në 5 vite të barabarta është qasje e drejtë, meqenëse te njëjtat lejohen dhe pershtatën për 5 vite, por përdorimi i qasjes së njëjtë për faktorin korigjues është në kundërshtim me rregullën për të hyrat e OSSH-së, e cila aplikohet gjatë përshtatjeve të rregullta tarifore.

Prandaj, kërkojmë nga rregullatori të aplikoj saktë përshtatjet, duke mos penalizuar dhe rënduar pozitën financiare të operatorit të sistemit të shpërndarjes, i cili ka mbuluar këto kosto brenda vitit relevant.

6. Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për periudhën rregullative

Tabela e mëposhtme përmbledh të Hyrat e Lejuara Maksimale të kërkuar nga OSSH-ja për periudhën e tretë rregullative 2023-2027 duke marrë parasysh arsyetimin për komponentët e kostove të paraqitura në seksionet e mësipërme të këtij dokumenti.

€000s	PRR3				
	2023	2024	2025	2026	2027
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Baza e Opex-it	33,843	34,611	35,304	35,927	36,463
Kosto e humbjeve	90,457	80,690	73,499	67,492	62,648
Zhvlerësimi	19,080	20,986	22,991	23,883	25,408
Kthimi i Lejuar	17,312	18,557	19,812	20,854	21,643
Kostot e përjashtuara	-	-	-	-	-
Të hyrat jo-tarifore	-5,000	-5,000	-5,000	-5,000	-5,000
Obligimet ndaj OS dhe OT	1,934	1,934	1,934	1,934	1,934
Taksa për licence	90	90	90	90	90
HLM fillestar	157,716	151,867	148,628	145,180	143,186
Përshtatjet 2022 dhe PRR2	29,699	(3,998)	(3,998)	(3,998)	(3,998)
Gjithsejtë HLM i propozuar	187,414	147,869	144,630	141,182	139,188

Duke marrë parasysh sfidat që e presin sektorin energjetik e veçanërisht Operatorin e sistemit të shpërndarjes gjatë pesëvjeçarit e ardhshëm, si rezultat edhe i procesit të tranzicionit energjetik, është më se e domosdoshme që ZRRE të reflektoj para çdo marrje të vendimit përfundimtar lidhur me të hyrat e lejuara maksimale për periudhën e tretë rregullative 2023-2027. OSSh beson se kërkesa e vet është e drejtë dhe e domosdoshme që sistemi i shpërndarjes të funksionojë siç duhet. Qëllimi i OSSh-së është të ofrojë shërbime më të mira për konsumatorët e vet, megjithatë për të bërë këtë duhet që kostot e nevojshme për operimit të lejohet dhe të mundësohen nga rregullatori.